



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr. 355 prot

Tiranë, më 25/06/2026

VENDIM

Nr. 7 datë 25/06/2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 24/6/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 24. 6. 2026 vendosi:

- 1. Për projektvendimin “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të komisionit këshillimor për titujt e nderit”** propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
- 2. Për projektvendimin “Për landfillet e mbetjeve”** propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të përcaktohet një analizë financiare e detajuar për bashkitë në raport me standardet të cilat duhet të respektohen në lidhje me landfilld-et e mbetjeve, si dhe të parashikohen qartë të dispozitat tranzitore në lidhje me statusin e landfillde-ve ekzistuese

**3. Për projektvendimin “Për përcaktimin e dokumentacionit, afateve dhe procedurës së konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit”** propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në pikën 2 referuar ligjit nr.57/2020 i ndryshuar, neni 12/pika 2, si dhe Ligji 9693/2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar, parashikohen dy definicione ligjore mbi pronësinë shtetërore për pyjet, të cilat janë: Fond Pyjor/kullosor në pronësi/administrim të Ministrisë përgjegjëse për pyjet ku kemi dy definicione të pronësisë/administrimit, pra nga organe publike në nivel qendror dhe ato në nivel lokal-NJVV, nuk mund të jetë në diskrecionin e Kryetarit të Bashkisë/si autoriteti përfaqësues i organit të pushtetit vendor, për të qënë në rolin e qiradhënësit edhe për ate fond pyjor/kullosor ku do të ushtrohet aktivitetit i gjuetisë/mbarështimit/ripopullimit, i cili rezulton në pronësi apo administrim të organit qendror, Ministrisë përgjegjëse për pyjet (nëpërmjet AKZM).

Në pikën 2 ku parashikon që kryetari i bashkisë ngre me urdhër komisionin, të riformulohet si më poshtë:

“Kryetari i bashkisë ngre me urdhër komisionin për ndjekjen dhe vlerësimin e procedurave të konkurrimit publik. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë, ku përfshihen detyrimisht:

- a) përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin pranë bashkisë;
- b) përfaqësuesi i strukturës juridike të bashkisë;
- c) specialist i fushës së faunës së egër, pylltarisë, biologjisë ose veterinarisë;
- ç) një përfaqësues i shoqatave ose federatave të gjuetarëve që operojnë në territorin e bashkisë;
- d) një përfaqësues i organizatave mjedisore ose i institucioneve akademike, kur është e mundur;

Në pikën 3 të shtohen elementet:

“Njoftimi shoqërohet detyrimisht me:

- a) hartën dhe koordinatat e zonës;
- b) planin e menaxhimit të zonës, kur ai është miratuar;
- c) inventarin e faunës së egër dhe metodologjinë e përdorur për hartimin e tij;
- ç) projektkontratën e qirasë;
- d) informacion mbi statusin e pronësisë dhe kufizimet mjedisore të zonës;
- dh) kriteret e plota të pikëzimit dhe mënyrën e verifikimit të tyre”

Në pikën 6 të shtohet:

“Subjekti konkurrues duhet të provojë eksperiencë të dokumentuar jo më pak se 3-vjeçare

në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

- a) menaxhim i faunës së egër;
- b) administrim i zonave të gjuetisë;
- c) mbarështim dhe ripopullim i llojeve të faunës;
- ç) ruajtje e habitateve natyrore;
- d) luftë kundër gjuetisë së paligjshme;
- dh) aktivitete edukimi dhe trajnimi në fushën e gjuetisë së qëndrueshme.”

Pika 6 shkronja “f” të ndryshohet:

“Plani teknik i menaxhimit dhe investimeve për zonën e gjuetisë, mbarështimit ose ripopullimit, i cili duhet të jetë në përputhje me planin e menaxhimit të zonës dhe të përmbajë:

- a) masat për mbrojtjen dhe shtimin e faunës;
- b) masat kundër gjuetisë së paligjshme;
- c) investimet në infrastrukturë dhe siguri;
- ç) masat për monitorimin biologjik;
- d) masat për ripopullim dhe mbarështim;
- dh) programin e bashkëpunimit me shoqatat vendore të gjuetarëve;
- e) burimet financiare dhe kalendarin e zbatimit.

Pika 8, shkronja “ç”, ku

oferta financiare vlerësohet me 25 pikë, po aq sa kapacitetet teknike dhe profesionale, e cila mund të krijojë risk që një ofertë ekonomikisht më e lartë të kompensojë mungesën e përvojës reale apo kapaciteteve biologjike dhe profesionale. propozohet që  
“Oferta financiare të mos vlerësohet me më shumë se 15 pikë. Plani i menaxhimit, kapacitetet profesionale, përvoja në ruajtjen e faunës dhe investimet konkrete në zonë të përbëjnë së bashku jo më pak se 70% të pikëve totale

Pika 8, shkronja “b”, i referohet shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 6, ndërkohë që plani i biznesit ndodhet te shkronja “f”. Ndërsa pika 8, shkronja “c”, i referohet shkronjave “e” dhe “ë”, të cilat lidhen me eksperiencën dhe deklaratën e përgjegjësive, jo me kapacitetet teknike. Propozohet të rishkruhet plotësisht për të shmangur paqartësitë:

“Vlerësimi i ofertave kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) plotësimi i kërkesave ligjore dhe dokumentacionit të detyrueshëm -15 pikë;
- b) plani i biznesit dhe plani i menaxhimit të zonës -30 pikë;
- c) plani vjetor i përdorimit të faunës së egër -15 pikë;
- ç) kapacitetet teknike, profesionale dhe personeli i kualifikuar -20 pikë;
- d) përvoja e provuar në menaxhimin e faunës së egër dhe habitateve natyrore -10 pikë;
- dh) oferta financiare -10 pikë.”

Të shtohet një nen në lidhje me garancinë për aksesin e gjuetarëve të licencuar ku  
“Menaxhuesi i zonës së gjuetisë garanton akses të barabartë dhe jodiskriminues për gjuetarët e pajisur me leje të vlefshme, në përputhje me kuotat, sezonin e gjuetisë, planin vjetor të përdorimit dhe rregullat e sigurisë.

Pikat 9, 10 dhe 11 në lidhje me transparencën e vlerësimit dhe publikimin e raportit propozohet që “Raporti i vlerësimit, tabela e pikëzimit për secilin konkurrenues, procesverbali i hapjes së ofertave dhe vendimi për shpalljen e fituesit publikohen në faqen zyrtare të bashkisë brenda 2 ditëve pune nga miratimi i tyre.

Në pikën 10, të parashikohet se drafti i kontratës së qirasë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 9, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t’ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër

Pika 12 në lidhje me rishikimin e mekanizmit të ankimit propozohet që ankimi administrativ shqyrtohet nga një komision i posaçëm pranë bashkisë, i ndryshëm nga komisioni i konkurrencimit, ku përfshihet një jurist, një specialist i biodiversitetit dhe një përfaqësues i shoqatave/federatave të gjuetarëve. Vendimi i arsyetuar i ankimit publikohet dhe i njoftohet palës ankuese.”

Pika 13 citon që ”Kontrata duhet të përfshijë detyrime të qarta për komunitetin dhe faunën”, propozohet që “Kontrata e qirasë duhet të përmbajë detyrimisht:

- a) planin e investimeve dhe afatet e realizimit;
- b) treguesit minimalë të monitorimit biologjik;
- c) masat kundër gjuetisë së paligjshme;
- ç) detyrimin për raportim vjetor publik;
- d) kushtet e aksesit të gjuetarëve të licencuar;
- dh) mekanizmin e bashkëpunimit me shoqatat vendore të gjuetarëve;
- e) kushtet për pezullimin ose zgjidhjen e kontratës kur cenohen fauna, habitatit apo siguria.”

**4. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në menca dhe konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar** propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Pika 2.1/a shfuqizohet togfjaleshi “që akomodohen në konvikte publike”, ministritë përgjegjëse duhet të parashikojnë paralelisht rritjen e numrit të kuotave të bursave sipas statistikave të familjeve në skemen e ndihmës ekonomike të bashkive përkatëse, pasi ky kriter në këto kushte ligjore do rrisë numrin e nxënësve që ploteëojnë kriteret në mase. Bashkia Tiranë trajton rreth 2000 familje me ndihmë ekonomike dhe rreth 80% e tyre i ka fëmijët në moshë shkollore cka i bën automatikisht përfitues të bursës sipas kriterit ekonomik.

Pika 2.1/a “Heqja e kushtit "akomodim në konvikt" çon në rritje të konsiderueshme e numrit të aplikantëve të kualifikuar pa rritje të fondeve nga MAS. Nxënësit e arsimit profesional humbasin bursën vetëm në rast përsëritjeje (pika 3/1) sërish përkon në rritje e qëndrueshmërisë së përfituesve, reduktim i "qarkullimit" të fondeve;

Të qartësohet pika 3 se si do të zbatohet dhe a do të aplikohet vetëm për nxënësit e arsimit të përgjithshëm dhe nxënësit e arsimit profesional të cilët janë të përjashtuar nga geramat a dhe b, kur nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme “në arsimin e përgjithshëm” nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj;

Pas pikës 8, shtohet pika 8.1 që përcakton se: “Në rastet kur numri i nxënësve që ndjekin arsimin e përgjithshëm që plotësojnë kriteret për përfitim të bursës është më i lartë se mundësitë e financimit të miratuara për atë vit shkollor dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të mbulojë me fondet e veta mbështetjen për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret, njësia e vetëqeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, përcakton rregullat për shpërndarjen e bursave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi”sepse shtesë krijon paqartësi mbi përgjegjësitë dhe procedurat që duhet të zbatohen njësitet e qeverisjes vendore në zbatim të V.K.M 666/2019, i ndryshuar;

Pika 8/1. Këshilli Bashkiak ka kompetencën për të përcaktuar rregullat e shpërndarjes kur kërkesat tejkalojnë fondet mund të çojë në interpretime të ndryshme dhe kritere prioriteti që ndryshojnë nga Njësitet Vendore, duke krijuar pabarazi territoriale dhe rrezik diskriminimi, siç ka konstatuar edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në rastet e mëparshme, ndaj duhet një udhëzim i qartë nga MAS mbi kriteret minimale të prioritizimit, vendimet e VKB-së mund të jenë objekt ankimi.

Të sqarohet pika 12, se ku duhet të aplikojnë nxënësit jo vetëm në klasen e 10, por në të gjitha vitet e arsimit parauniversitar klasat 1-12, sqarimi për klasen e 10 në këtë vkm i është referuar nxënësve të shkollave profesionale që vijnë nga rrethet e tjera në Tiranë, pra ku duhet të aplikojë për bursë çdo nxënës i arsimit parauniversitar, sipas vendbanimit të përhershëm apo vendndodhjes së shkollës;

Pika 15/1 të ketë përmbajtjen; Njësitet e vetëqeverisjes vendore dorëzojnë kërkesat për fondet e bursave brenda muajit shkurt. Për kërkesat e dorëzuara jashtë këtij afati bursat mund të mbulohen me fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Pikat 15/1 dhe 23, në lidhje me uungesat e mekanizmit të garantuar të transferimit ku NJVV-të ngarkohen me administrimin e pagesave, por nuk përcaktohen afatet dhe modalitetet e kalimit të fondeve nga buxheti i shtetit drejt NJVV-ve.

Të qartësohet pika 22/1 e cila përcakton se “Njësitet e vetëqeverisjes vendore, me fondet e tyre buxhetore apo transfertës nga buxheti i shtetit, për institucionet arsimore parauniversitare publike në territorin që mbulojnë, mund të ofrojnë shërbimin e ushqimit për nxënësit, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara nga autoritetet përgjegjëse për ushqimin, nëse shërbimi i ushqimit referohet kategorive të nxënësve sipas vkm 666/2019 apo i referohet të gjithë nxënësve të arsimit parauniversitar;

Të qartësohet dryshimi i pikës 23, nëse ky ndryshim parashikon që nxënësit në konvikte nuk do të marrin pagesë financiare bursën por si kuotë ushqimore, apo do zbritet nga pagesa e konviktit dhe nëse pagesa /kosto e konviktit është e barabartë me vlerën financiare të bursës që do marrin nxënësit e tjerë dhe referuar procedurave të aplikimit ato fillojnë në periudhën shtator-tetor, mbledhja e kërkesave nëntor dhe miratimi dhjetor. Pagesa mujore "brenda datës 10 të muajit pasardhës" është e vështirë të vihet në zbatim. Te specifikon në mënyrë të qartë nëse fondet e transferuara nga MAS përfshijnë edhe shkollat 9-vjeçare, apo vetëm arsimin e mesëm. Kjo pasiguri krijon vështirësi në planifikimin buxhetor vendor.

Pika 30/1 në lidhje me “Indeksimin Automatik dhe Planifikimi Buxhetor”. Buxheti vendor miratohet në nëntor/dhjetor për vitin pasardhës, ndërsa indekset e INSTAT publikohen gjatë vitit. Është i nevojshëm një mekanizëm rregullues që të lejojë NJVV-të të përditësojnë planifikimin pa çënuar shërbimet e tjera;

Pika 21 “Kuota për Fëmijët me Nevoja të Veçanta”. Kuota aktuale prej 150 lekësh për fëmijët me nevoja të veçanta është e pamjaftueshme në raport me rritjen e çmimeve (ICK/INSTAT). Kërkohet rishikimi i kësaj kuote duke u marre shkas se të gjitha kuotat e tjera kanë ndryshuar.

Të adresohet në projektvendim shtimi i vaktit të mëngjesit për fëmijët me nevoja të veçanta, pasi nxënësit që vijnë me transport nga fshatrat arrijnë në shkollë para orës 08:00.

Të qartësohen mekanizmat e financimit midis pushtetit qendror dhe atij vendor, shmangia e transferimit të pasigurive buxhetore tek pushteti vendor, Harmonizimi i afateve administrative me realitetin operacional të shkollave dhe bashkive dhe garantimi i barazisë territoriale në aksesin ndaj shërbimeve të mbështetjes sociale.

Të qartësohet koncepti “familje në nevojë ”dhe“ pamundësi financiare”, i cili duhet të përcaktojë në mënyrë më të qartë kriteret ekonomike që klasifikojnë një familje si “në nevojë”, për të shmangur interpretimet subjektive dhe konfliktet administrative gjatë shqyrtimit të aplikimeve;

Të ketë rritje të fondit të dedikuar për bursat dhe krijimi i një fondi rezervë kombëtar për bashkitë me numër të lartë aplikimesh;

Në lidhje me krijimin e aksesit elektronik ndërinstitucional për verifikimin e dokumentacionit sugjerohet që bashkitë të kenë akses të integruar në sistemet shtetërore për verifikimin automatik të:

- ndihmës ekonomike;
- statusit të jetimit;
- pagesës së aftësisë së kufizuar;
- të ardhurave familjare.

Të përcaktohet një mbështetje financiare për bashkitë që ofrojnë ushqim në shkolla duke qenë se ofrimi i ushqimit në shkolla krijon kosto të konsiderueshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku propozohet:

- financim i dedikuar nga buxheti i shtetit;
- grant specifik për bashkitë që zbatojnë programin;
- standarde të unifikuara për menaxhimin e këtij shërbimi.

**5. Për projektvendimin “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionare Shtetërore”,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të rishikohet situata në rast ngërçi institucional për miratimin nga Këshilli Bashkiak për kandidaturat e propozuara nga Komisioni i Përhershëm i Emërimit, si dhe të verifikohet kuadri ligjor në fuqi nëse çënohet autonomia vendore.

**6. Për projektvendimin “Për organizimin, funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe procedura e shqyrtimit të ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje”** propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në nenin 2, pjesa i përket funksionimit dhe përbërjes së Komisionit, sugjerohet që të specifikohet që Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave është i ndryshëm nga Komisioni Multidisiplinar i Kujdestarisë;

Në nenin 3, pika 1, në lidhje me përbërjen e Komisionit, sugjerohet që të shtohen dhe përfaqësues nga struktura përgjegjëse e Burimeve Njerëzore;

Në nenin 7, pika 5, të shtohet ndër të tjera edhe Policia e Shtetit.

**7. Për projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit të shërbimit”**, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin

**8. Për projektvendimin “Për kriteret dhe procedurat e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje”**, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Në pikën 2, të nenit 3, të përcaktohet në mënyrë të shprehur që komisioni të ngrihet me urdhër të kryetarit të Bashkisë, si dhe të përcaktohet përbërja e këtij komisioni;

Të shtohet në nenin 3, shkronja “a”, që organizata duhet të ketë marrëveshje bashkëpunimi në bashkinë ku operon;

Të shtohet në projektvendim detyrimi i organizatës për të raportuar pranë Bashkisë.

**9. Për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”**, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.

**10. Për projektvendimin ”Për procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje dhe kriteret, procedurat dhe**

instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje”, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.

11. Për projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ në familje, ofrimin dhe përfundimin e shërbimit, funksionimin e komisionit shumë disiplinor dhe për vlerësimin e procedurës dhe vendimmarrjen për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje” propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Të parashikohen fushata ndërgjegjësuëse në media, rrjete sociale, takime informuese në njesitë administrative, materiale informuese për qytetarët, procedurat dhe përfitimet e kujdestarisë familjare;

Të përcaktohen qartë masët e mbështetjes financiare; rimbursimin e shpenzimeve shtesë që lidhen me arsimimin, shëndetin dhe nevojat e veçanta të fëmijës;

Të njihen Njesitë e Mbrojtës së Femijes me regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ.

12. Prezantim “Udhërrëfyes mbi planin vjetor të aktiviteteve të komisionit të këshillimit ad hoc”. “Mekanizmi për verifikimin e përfshirjes së rekomandimeve të këshillit konsultativ”. “Guide praktike mbi metodologjinë e hartimit të rekomandimeve/ propozimeve për iniciativa ligjore” propozuar nga Projekti EU4GOODGOVERNANCE, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehë dakordësinë në parim me dokumentin.

Z. Ervin Demo  
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin Dalipi  
Kryetar/Bashkëkryetar  
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë